

RELACION

OBJEKTI: RIKONSTRUKSIONI I RRUGES “PERROI I ZI” & “SHKENDI”, BASHKIA BELSH

Pas marrjes se detyres se projektimit per objektin e mesiperm u fillua nga puna per konkretizimin e projektit .

Në fshatin Shkendi jetojne një komunitet i madh banorësh. Deri më sot këtë fshat janë bërë investime në infrastrukturë, ne rrugen kryesore te saj por ky nivestim ka dale jasht perdorimit nga amortizimi i tij, kjo per arsye te deformimeve dhe cedimeve te saj ne te gjithë siperfaqen e saj .Kjo zone ka nje sepcifike. Duke qene kryesisht zone torfike ka ngritje te larte te nivelit te ujerave nentoksore dhe ne vere ka carje te tokes te cilat vene 1.5 m thellesi .Ne projektet e meparsheme keto veti nuk jane marre paysarsh keto elemente prandaj kane ndollur keto deformacione te medha deri ne nxjerrjen e rruges jasht funksionit te saj.

Ndertimi i kesaj rruge do të krijojë kushte lehtësuese komunikimi të banorëve me qendren belsh dhe me te gjithë zonen.

Në fshatin Shkendi afersisht ne qender te saj është shkolla 9 vjecare dhe rruga ben lehtësimin e lëvizjes jo vetëm të banorëve, por sidomos të nxënësve të këtij fshati për të vajtur në shkollë.

Gjithashtu, kjo rrugë do të krijojë mundësi më të mëdha edhe për investime të tjera në këtë fshat, si në fushën e bujqësisë, blegtorisë, por per me shume per nje jetese me te kulturuar, te cilat aktualisht jane në gjëndje të rrënuar, Me ndërtimin e rruges e me vone te rrjetit te kanalizimeve e te rrjetit te ujësjellsit për çdo lagje mendojme qe do te kete investime të tjera jo vetëm tregëtare e bujqesore por edhe në fushën e turizmit, që nënkupton kthimin e banorëve të larguar dhe rindërtimin e banesave të tyre për qëllime turistike, fakt që do të çonte në rigjallërimin e këtij fshati e te jeteses ne pergjithesi. Meqënëse ky fshat është një zonë fushore kodrinore realizimi i investimeve te mësipërme do të ndikonte fuqishëm dhe direkt në rritjen e mirëqënies së këtij komuniteti.

Gjatësia totale e rrugës është afërsisht 1600 ml, aktualisht për këtë rrugë ka përfundur projekti dhe pritet vetëm zbatimi i tij.Gjeresia asfaltike e rruges eshte menduar 2.8 ml per arsye qe te mos kemi te bejme me problemet e

shpronesimeve. Kjo gjeresi eshte normale per numrin e mjeteve qe do te kalojne ne kete zone.

Projekti eshte llogaritur edhe me shtresat asfaltike. Zbatimi i saj mund te behet me faza ose njeheresh kjo sipas mundesive financiare.

Bankina e kesaj rruge do te jete 0.5-0.7m. Kanali anesore i rruges ne pjeset me pjerrtesi te madhe do te jene te veshura me beton, kjo per te ruajtur trupin e rruges nga gerryerjet dhe per largimin e ujerave ne menyre te kontrolluar, kjo gjithmone per te ruajtur trupin e rruges.. Per sa i perket nenshtresave rrugore eshte menduar qe te vendoset nje shtrese 15 cm cakull guroreje dhe shtresa mixer 10cm me binder dhe asfaltobeton me gur kave. Eshte menduar qe te perdoret edhe material rrethanor shkembor per mbushjen e trasese dhe per formimin e trupit te rruges ne vende te caktuara. Keto shtresa do te ngjishen secila me rrul 8-12 ton me nga 6-9 kalime secila shtrese . Nje cikël i tille ngjeshje duhet te perdoret edhe per nenshtresat rrugore. Ne disa pozicione per te siguruar trupin e rruges nga problemet e carjeve te thella ne vere dhe ngritja e larte e nivelit te ujerave ne dimer do te perdoret shtresa gjeotekstili. Per te percaktuar sasine e perdorur kjo do te percaktohet ne terren hap pas hapi zbatimit te punimeve. Per sa i perket bankines anesore eshte menduar qe ajto te ndertoht me cakull. Funkcioni i saj eshte si te mbrojne shtresat e rruges , por edhe te lejojne kalimin e njerezve opo te kafsheve te zones.

REFERIMI I CMIMEVE

Ne kete material percaktohen operacionet perberese te cdo zeri pune ne preventiv. Kjo sherben per nje percaktim te sakte te cmimit te ofertes per cdo ze pune.

- **Mbushje dhe profilim traseje rruge.**

Ky cmim perfshin te gjitha shpenzimet per blerjen , transportin dhe shtrimin per mbushjen e trupit te rruges me material cakull meturina te guroreve ose material tjeter rrethanor te pershtatshem te miratuar paraprakisht nga Supervizori , realizimin e trupit te rruges dhe bankinave sipas projektit, ngjeshjen me shtresa dhe trajtimin e tyre . Ngjeshja duhet te behet me shtresa sipas KTZ-se. Materiali duhet te kete lageshtine dhe konsistencen e duhur per te arritur koeficientin e ngjeshjes optimale. Ky cmim i referohet nje njesie me operacionet e mesiperme.

- **Shtrese cakulli guroreje (15) cm**

Ky cmim perfshin teresine e punimeve dhe te puntorise qe lidhet me blerjen e **cakullit guroreje** , ngarkimin, transportin, dhe helljen ne veper si dhe rrulimi me rrul 8-12 ton me 6-8 kalime vajtje – ardhje , sipas kushteve teknike te zbatimit , sipas profilit te paraqitur ne projekt . Ky cmim i referohet 1m2 .

- **Strese Asfaltobetoni 4cm .**

Ne kete cmim perfshihet kostoja e punimeve dhe e puntorise qe lidhet me blerjen dhe hellen ne veper te shtreses se asfaltobetoni, pavaresisht nese ky kryhet me krahe apo me makineri .Ketu perfshihet edhe kostoja e cilindrimit me rrul 10-12 ton per sicilen shtrese.Asfaltobetoni i perdorur duhet ti pergjigjet te gjitha kushteve teknike ne fuqi . Cmimi i pergjigjet 1m2.

2. Gjendja e faktit të teknologjisë Asphalt Rubber

Konglomerati Asphalt Rubber është paketuar me bitum të modifikuar me pluhur gome marrë nga gomat e ricikluara ose nga goma natyrore, për më shumë se 30 vjet, është përdorur me sukses të madh si në Shtetet e Bashkuara, në Arizona, Kaliforni, Teksas dhe Florida, si në Jug Afrika, Kanadaja dhe saktësisht është një proces industrial i kontrolluar, pluhuri i gomës ose goma natyrale thith dhe fikson fraksionin e përbërësve të avullueshëm aromatike të bitumit, në të cilën gjatë kohës duhet plakja e lidhësit. Kështu realizohet një bitum i modifikuar me performancë të lartë me cilën mund të përfitojmë një konglomerat bituminoz jashtëzakonisht fleksibël dhe të qëndrueshëm. Ky konglomerat është veçanërisht i përshtatshëm për të reduktuar të gjitha fenomenet e reflektimit të plasaritjeve, plasaritje lodhjeje dhe plasaritjet termike, me përfitimin sipërfaqeve të pa fenomenin e tërheqjes së timonit (rutting), me një aderim të mirë (Skid resistance), zvogëlimi i nevojës

të mirëmbajtjes, një rregullsi të mirë dhe nivelet e reduktuara të zhurmës.

Ka mundësi të ndryshme të përdorimit Asphalt Rubber me avantazhe të ndryshme që konsistojnë në:

- Përformancë dhe qëndrueshmëri të lartë
- Mundësia e aplikimit të trashësive më të ulëta të konglomeratit që gjithashtu çojnë për të ulur kohën e ndërtimit e lidhur me përdorimin e më pak materialeve [kursimin e risorseve natyrore]
- Reduktimi i zhurmës (ekuivalente me 85% më pak trafik)
- Rritja e sigurisë për shkak të reduktimit të fenomenit të spërkatjes nga uji [splash and spray] dhe [acqua planning] dhe rritjen e shikimit natën, për shkak të ngjyrës së errët e vazhdueshme gjatë gjithë kohës që krijon kontrast midis dyshemesë dhe senjalistikës horizontale
- Përmirësimet e aderimit, cilësi dhe rregullsi e sipërfaqes (IRI)
- Ripërdorimi i sasive të mëdha i gomave të përdorura dhe njëkohësisht ruajtjen e burimeve natyrore
- Përkufizimi Asphalt Rubber sipas normës ASTM D6114 Është një bitum i modifikuar me një përqindje minimale të pluhurit të gomave të ricikluara ose gome natyrale në 15% të peshës totale të lidhjes, inkorporuar nëpërmjet procesit të lagësht Wet, i cili ka reaguar gjatë një periudhe kohe mjaftueshmërisht të gjatë të lejojë fryerjen e gomës .

- **Strese Binberi 6cm.**

Ne kete cmim perfshihet kostoja e punimeve dhe e puntorise qe lidhet me blerjen dhe hellen ne veper te shtreses se binderitt, pavaresisht nese ky kryhet me krahe apo me makineri .Ketu perfshihet edhe kostoja e cilindrimit me rrul 10-12 ton per sicilen shtrese.Binderi i perdorur perdorur duhet ti pergjigjet te gjitha kushteve teknike ne fuqi . Cmimi i pergjigjet 1m2.

- **Sperkatje me bitum te siperfaqes.**

Ne kete ze perfshihet pastrami i siperfaqes dhe sperkatja me bitum I siperfaqes ne te cilen do te hillet binderi apo asfaltobetoni. Materiali I

perdorur duhet te plotesoje kushtet teknike ne fuqi . Ky cmim I pergjigjet 1m2.

- **Betonime monolite M-150/200**

Ky cmim perfshin te gjitha shpenzimet per furnizimin , transportin , e depozitim e materialeve ne objekt, realizimin e kallepeve te derrases sipas dimensioneve dhe betonimin e kunetave,kanalit te betonit dhe pusetave , portaleve me beton M-150(200). Kallepet duhet te realizohen me derrase te paster , sipas dimensioneve te kerkuara dhe te vendosura sipas projektit. Betoni duhet te realizohet me inerte lara me granulometrine e duhur dhe sipas normativave te percaktuara per betone te markes 150(200) si dhe ne konsistencen e duhur. Ketu futet edhe trajtimi i betonit me uje sipas KTZ- se ne fuqi. Duhet te mbahen kubiket e proves per cdo dite dhe marke ne prani te supervizionit. Ky cmim i referohet 1m3 beton.

- **Punime germimi.**

Ne punimet e germimit perfshihet teresia e punimeve si germim i seksioneve te percaktuara ne projekt, ngarkimi i tyre ne automjet si dhe transporti i tyre ne nje vend te pershtatshem e te lejuar per depozitim dherash. Cmimi i pergjigjet 1 m3.

- **Punime germimi kasonete.**

Ne punimet e germimit per kasonete perfshihet teresia e punimeve si germim i seksioneve te percaktuara ne projekt, ngarkimi i tyre ne automjet si dhe transporti i tyre ne nje vend te pershtatshem e te lejuar per depozitim dherash. Cmimi i pergjigjet 1 m3.

- **Vendosje tubo per tombino**

Per te realizuar mire funksionimin e kanaleve ansore ne te gjithe gjatesine jane parashikuar qe ne cdo hyrje banese te realizohet nga nje tombino me dimensione nga 300-400 ml sipas pozicionit te percaktuar ne

projekt. Ne kete ze parashikohet si blerja e tubove transporiti, e deri tek vendosja e tyre ne objekt.

Ky ze mund te negociohet me banoret perkates qe kete ze pune ta perballojne ata nese ka mundesi , ne projekt parashikohen qe te dy variantet . Kjo procedure perlllogaritje eshte perdorur edhe ne dimensionet e tjera te tobinove. Cmimi i perket nje ml tubi .

Per cdo problem qe do te dale gjate zbatimit te objektit do te lajmerohet Supervizori si dhe Projektuesi i cili duhet te beje miratimin e ndryshimeve .Cdo ndryshime apo plotesim ne permiresimin e zbatimit te ketij projekti kane vlere me miratimin perkates te investitorit .

Punoj:

Ing. Kastriot BEGAJ

